

fq. 2 Zhvillohet Mbledhja e 21-të Vjetore e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2014 *fq. 3*
- » Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2014 *fq. 4*

ZHVILLIME TË TJERA

- » Konferenca e 39-të Vjetore e IOSCO-s *fq. 6*
- » Konferenca e dytë rajonale e sigurimeve *fq. 8*
- » Takimi i 8-të i nismës së mbikëqyrjes së sigurimeve, CESEE *fq. 9*
- » Takimi i Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë Vienna Insurance Group (VIG) *fq. 10*
- » Seminar për mbikëqyrjen me fokus rreziku për një treg sigurimi më të qëndrueshëm dhe transparent *fq. 11*
- » Seminar për mbikëqyrjen e sigurimeve *fq. 12*
- » Mbledhje e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Group Austria *fq. 13*
- » Seminar mbi kuadrin rregullator lidhur me shkeljet globale dhe ndërkufitare në fushën e letrave me vlerë *fq. 14*

LAJMET NGA RAJONI

- » Greqi » Qipro » Rumani » Slloveni *fq. 15-16*

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Zhvillohet Mbledhja e 21-të Vjetore e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi gjatë periudhës 20-25 tetor 2014 në Amsterdam, Holandë, Mbledhjen e 21-të Vjetore me temë “Rritja e mbrojtjes konsumatore dhe stabilitetit financiar përmes qeverisjes dhe administrimit të rrezikut”. Kjo mbledhje përkonte edhe me 20 vjetorin e IAIS-it, që sot ka rreth 210 anëtarë nga 150 juridiksione në vende të ndryshme të botës. Pjesëmarrës në këtë Mbledhje Vjetore ishin përfaqësues nga autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve, ekspertë dhe zyrtarë të lartë të organizatave ndërkombëtare.

Në fjalën përshëndetëse në Mbledhjen Vjetore, Sekretari i Përgjithshëm i IAIS-it, si dhe Kryetari i Komitetit Ekzekutiv pasqyruan ecurinë ndër vite të shoqatës, rritjen e saj nga një grup i vogël, fokusi kryesor i të cilit ishte mundësimi i bashkëpunimit mbikëqyrës dhe shkëmbimit të informacionit, në një trupë ndërkombëtare hartuese të standardeve të sigurimit, dhe pjesë integrale e rëndësishme e përpjekjeve për të siguruar stabilitetin financiar. Gjithashtu, ata theksuan vullnetin për të çuar përpara shoqatën në kërkim të sfidave të reja me të cilat anëtarët e IAIS-it mund të përballen gjatë 20 viteve të ardhshme, me diskutime të asaj se çfarë shoqëria dhe sistemi ekonomik mund të jetë në të ardhmen dhe me çfarë rreziku mund të përballlet industria.

Ndër diskutimet kryesore të Mbledhjes Vjetore-2014 ishin:

- » Zhvillimet dhe sfidat në mbikëqyrjen e sigurimeve;
- » Standardet në kapitalin e shoqërive të sigurimit dhe kërkesat mbi kapitalin minimal fillestar;
- » Qasje të reja për qeverisjen e sigurve;
- » Tregjet e kapitalit dhe modelet e biznesit në një mjedis sfidues të normave të interesit;
- » Rimëkëmbja, zgjidhjet dhe bashkëpunimi mbikëqyrës.

Gjatë ditëve të zhvillimit të mbledhjeve të komiteteve të punës u diskutua synimi për përcaktimin e një raporti të drejtë midis rregullimit e mbikëqyrjes nga njëra anë dhe mbrojtjes së investitorëve e konsumatorëve nga ana tjetër.

Aktivitetet u siguruan të pranishmëve mundësi të vlefshme për shkëmbim të mendimeve, përvojave të ndryshme dhe për nxitjen e iniciativave, të cilat do të ndihmojnë në forcimin e stabilitetit në sektorin e industrisë së sigurimit dhe shërbimeve financiare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate, u përfaqësua në këtë aktivitet nga një delegacion i nivelit të lartë.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 45.21% gjatë periudhës janar-shtator 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 8.58 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 0.07% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 757,913 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto në total, regjistruan një rritje me 1.40% në krahasim me periudhën janar-shtator 2013.

Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.66 miliardë lekë, apo 83.08% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës gjatë periudhës janar-shtator 2014 u rrit me 50.11%, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 5.03 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator 2014, duke shënuar një rritje prej 86.18% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 58.74% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 14.87% të tregut të Jo-Jetës;
- » Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 12.54% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 8.96% krahasuar me periudhën janar-shtator të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës, afro 57.73%, i përket sigurimit “Jetë debitori”.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2014

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2014 u dominua në masën 78.96% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 21.04% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 93.34% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2014 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 62.06% dhe 21.59% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.57 % të të gjitha transaksioneve në këtë treg.



- A- Blerje në tregun primar
- B- Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C- Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D- Vendosje e bonos si kolateral
- E- Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”**, gjatë periudhës janar-shtator 2014, ka pasur një rritje prej 912 milionë lekë ose 20.51%, krahasuar me periudhën janar-shtator 2013, ndërsa është ulur numri i transaksioneve në masën 7.84%.

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”**, gjatë periudhës janar-shtator 2014, ka pasur një rritje prej 105 milionë lekë ose 4.89%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013. Numri i transaksioneve është rritur në masën 0.72%.

Krahasuar me periudhën janar-shtator 2013, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 1,018 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale		Ndryshimi
		(në mln.lekë)		(në %)
janar-shtator		2013	2014	'14/'13-1
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	4,450.06	5,362.55	20.51
	<i>Individë</i>	<i>4,240.36</i>	<i>4,273.69</i>	<i>0.79</i>
	<i>Persona juridike</i>	<i>209.70</i>	<i>1,088.87</i>	<i>419.24</i>
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit	2,148.99	2,254.07	4.89
	<i>Individë</i>	<i>1,908.99</i>	<i>2,034.01</i>	<i>6.55</i>
	<i>Persona juridikë</i>	<i>240.00</i>	<i>220.06</i>	<i>(8.31)</i>

ZHVILLIME TË TJERA

Konferenca e 39-të Vjetore e IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*) zhvilloi gjatë periudhës 29 shtator-3 tetor 2014 në Brazil, Konferencën e 39-të Vjetore. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, është anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë.

Temat kryesore ku u fokusua Konferenca e 39-të Vjetore e IOSCO-s ishin zbatueshmëria e kuadrit rregullator, qeverisja e korporatave, financimi afatgjatë në dobi të rritjes ekonomike dhe mbrojtja e edukimi i investitorëve si faktorë kryesorë në rritjen e besimit të investitorëve. Konferenca arriti në konkluzionin se rregullatorët po ecin drejt ndërtimit të tregjeve financiare të mirërregulluar me synimin për të ndikuar në rritjen e qëndrueshme afatgjatë të ekonomisë në mbarë globin. Tregjet e letrave me vlerë janë bërë një burim financimi i rëndësishëm për nxitjen e rritjes ekonomike globale.

Kryetari i Bordit të IOSCO-s, Greg Medcraft theksoi ndër të tjera se *"... tregjet që ne rregullojmë janë duke u bërë gjithnjë e më shumë burime të rëndësishme financimi për nxitjen e rritjes ekonomike globale. Axhenda jonë e punës vazhdon të jetë e lidhur me ndërtimin e besimit në tregjet globale të kapitalit të cilat janë të drejta, transparente dhe të lira nga rreziku sistematik."*

Mbledhja e Bordit të IOSCO-s, me përfaqësues nga rregullatorë të letrave me vlerë si nga tregjet e zhvilluara ashtu edhe nga ato në rritje e zhvillim, nxiti disa iniciativa të rëndësishme nga këndvështrimi i rregullatorëve të letrave me vlerë, për të ndihmuar në kthimin e besimit në tregjet e letrave me vlerë, përmes mbrojtjes së investitorëve në këto tregje, adresimit të rreziqeve sistemike, si dhe për të lejuar që tregjet të luajnë rolin e tyre në rritjen ekonomike. Këto iniciativa ndër të tjera përfshijnë:

- » Hapat për finalizimin e metodologjisë për identifikimin e Institucioneve Financiare Jo-Bankare dhe Jo-Sigurime, me Rëndësi Sistemike (NBNI SIFIs) në tregun e ndërmjetësimit dhe të menaxhimit të aseteve;
- » Bashkëpunimin me Komitetin e Bazelit për mbikëqyrjen bankare për të mbështetur zhvillimin e tregjeve të qëndrueshme të letrave me vlerë që mbështesin produktet bankare, si një burim i rëndësishëm i financimit të ekonomisë reale;

- » Forcimin e cilësisë së auditimit;
- » Ecurinë e mëtejshme drejt zhvillimit të regjimeve efektive të zbatueshmërisë;
- » Shqyrtimin e mundësisë që tregjet të luajnë rolin e tyre si burim financimi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) dhe infrastrukturën;
- » Vazhdimin e punës për të zhvilluar një grup masash rregullatore lidhur me çështjet ndërkufitare.

Gjatë konferencës u diskutua për nismat ndërkufitare që adresojnë rreziqet kibernetike në tregjet financiare dhe përmirësimin e punës në identifikimin e këtyre rreziqeve.

Anëtarët e IOSCO-s ranë dakord që të vazhdojë puna në një variant të përmirësuar të Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, i cili do të zëvendësojë gradualisht atë aktual. MMoU aktuale, e cila filloi në vitin 2002, ka qenë e suksesshme në shkëmbimin e informacionit mes rregullatorëve në luftën e transaksioneve jo të ligjshme ndërkufitare. Përmirësimet e MMoU synojnë në rritjen e efektivitetit të shkëmbimit të informacionit në kushtet e përdorimit të teknologjisë dhe zhvillimeve të reja të tregut.

Komiteti i Tregjeve në Rritje dhe Zhvillim, me 90 anëtarë, në takimin e tij përforcoi rëndësinë e rritjes së kapaciteteve të përbashkëta rregullatore, duke përfshirë edhe menaxhimin e rrezikut sistemik.

Bordi i IOSCO-s publikoi dy raporte kërkimore që mbështesin politikat e tij për rreziqet e emergjencës dhe financimin afatgjatë:

1. “Vështrim mbi rreziqet në tregjet e letrave me vlerë, 2014-2015”, i cili fokusohet në identifikimin e rreziqeve potenciale në tregjet e letrave me vlerë.
2. “Zgjidhje mbi financimin afatgjatë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) dhe infrastrukturën”, i cili përshkruan zgjidhje të reja dhe praktike për lehtësimin e rritjes së kapitalit për SME-të dhe infrastrukturën.

Në mbledhje u diskutuan edhe çështje organizative të komiteteve përkatëse dhe zgjedhja e anëtarëve të organeve drejtuese.

Konferenca e dytë rajonale e sigurimeve

Në datat 1-2 tetor, në Beograd, Serbi, u organizua konferenca e dytë rajonale e sigurimeve me temë "Gjenerata e re e zgjidhjeve në sigurime". Konferenca u organizua nga Shoqëria e Risigurimit të Pronës nga Katastrofat, Europa Re.

Pjesëmarrësit në konferencë ishin nga autoritete rregullatore në sigurime dhe shoqëri që veprojnë në tregun e sigurimeve në Ballkan, kompani ndërkombëtare të risigurimit, organizma ndërkombëtarë si Banka Botërore, Sekretariati Zviceran Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), Organizata e Kombeve të Bashkuara me Strategjinë Ndërkombëtare për Reduktimin e Katastrofave (UNISDR). Ata paraqitën arritjet kryesore të realizuara në kuadër të programit Europa Re lidhur me zhvillimin e tregut të sigurimeve nga katastrofat gjatë tre viteve të fundit. Një vend i veçantë ju dha prezantimit zyrtar të produkteve të Swiss Visual Pro për përmbytjet dhe sigurimit nga tërmetet të banesave dhe bizneseve në Serbi, në bashkëpunim me shoqërinë partnere Energoprojekt Garant që është dhe shoqëri e akredituar në kuadër të programit.

Drejtori Ekzekutiv i Europa Re, Z. Heinz Vollenweider, theksoi se: *"Qëllimi kryesor i Europa Re është të ndihmojë rajonin në vënien në zbatim të një sistemi të qëndrueshëm të risigurimit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore duke krijuar mundësinë në rritjen e numrit të pronarëve të shtëpive, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe fermerëve, të cilët do të kenë mbrojtje nga sigurimi në rast katastrofash natyrore".*

Gjatë konferencës u theksua efekti ekonomik si pasojë e fatkeqësive natyrore të ndodhura në rajon, rëndësia e zbutjes së këtyre pasojave dhe u paraqitën këndvështrime të ndryshme lidhur me mundësinë e rritjes së kërkesës për sigurimin nga katastrofat në tregjet në zhvillim.

Programi i Europa Re u paraqit si "gjeneratë e re e zgjidhjeve në sigurime" për të zbutur efektin negativ të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore në vendet e Evropës Juglindore dhe për të siguruar në mënyrë afatgjatë qëndrueshmërinë financiare në rajon.

Takimi i 8-të i nismës së mbikëqyrjes së sigurimeve, CESEE

Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimit të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE, *Central Eastern and South-Eastern Europe*) zhvilluan takimin e 8-të të nismës së mbikëqyrjes së sigurimeve në datat 2-3 tetor në Kishinau, Moldavi, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar në këtë rajon. Nisma e CESEE shërben si një platformë për shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave midis mbikëqyrësve të sigurimeve.

Takimi pati katër sesione të ndryshme. Sesioni i parë diskutoi skemën e garancisë të sigurimeve si një nga mekanizmat kryesorë për mbrojtjen nga rreziku sidomos në rastin e falimentimit të shoqërive të sigurimit, temë e cila u mbajt nga Z. Klime Poposki (Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Maqedoni). Ky sesion u fokusua në trajtimin e çështjeve lidhur me funksionimin e këtyre skemave, mënyrat e financimit të tyre, si dhe shkëmbimin e rasteve të ndryshme të falimentimit të shoqërive të sigurimit në vendet pjesëmarrëse në takim.

Në sesionin e dytë u diskutua përvoja e tregjeve të ndryshme në zbatimin e standardeve ndërkombëtare, nga Z. Peter Braumüller (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Austri). Këtu pjesëmarrësit ndanë eksperiencat e tyre në lidhje me zbatimin e standardeve dhe parimeve ndërkombëtare në tregjet e tyre të sigurimeve.

Ndërsa dy sesionet e tjera u përqendruan në diskutimin e temave që lidheshin me produktet e sigurimit të detyrueshëm për pronën dhe mbikëqyrjen me fokus rreziku. Këto sesione u drejtuan nga Z. Artur Gherman (Komisioni i Tregjeve Financiare, Moldavi) dhe Z. Sergej Simoniti (Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Slloveni) dhe mbuluan ndër të tjera edhe tema si:

- » Kuadri ligjor për sigurimeve të pronës në vende të ndryshme;
- » Problemet kryesore në zbatimin e produkteve të sigurimit të detyrueshëm të pronës;
- » Pritshmëria e qasjes me fokus rreziku, sfidat dhe problemet kryesore në zbatimin e mbikëqyrjes me fokus rreziku;
- » Ndërthurja e mbikëqyrjes mikro dhe makro në kontekstin e mbikëqyrjes me fokus rreziku.

Takimi i 8-të i nismës CESEE shërbeu si një forum dinamik në shkëmbimin e përvojave ndërmjet përfaqësuesve të rregullatorëve nga 12 juridiksione të ndryshme të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, si dhe përfaqësues të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS).

Takimi i Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë Vienna Insurance Group (VIG)

Autoriteti Austriak i Mbikëqyrjes (FMA) zhvilloi në datat 6-9 tetor në Vjenë, takimin e radhës së Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë Vienna Insurance Group (VIG). Synimi i takimit ishte diskutimi i rezultateve financiare të këtij grupi gjatë vitit 2013. Përfaqësuesit e AMF-së merrnin pjesë për herë të parë në këtë takim, si mbikëqyrës të tre filialeve të grupit VIG në Shqipëri.

Pjesëmarrës të tjerë në takim ishin edhe përfaqësuesit e autoriteteve rregullatore të vendeve ku vepron shoqëria VIG, nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*), si dhe Drejtori Financiar (CFO) i shoqërisë VIG.

FMA paraqiti një projekt propozim që ka të bëjë me procedurat e vendimmarrjes nga mbikëqyrësit, në vendet ku VIG ka filialet e tij, deri sa *Solvency II* të hyjë në fuqi. Gjithashtu janë në diskutim dhe dy draft marrëveshje, Marrëveshja e Koordinimit dhe Marrëveshja e Konfidencialitetit, të cilat priten të miratohen nga secili mbikëqyrës në vendet ku VIG operon.

Formati i vlerësimit të rrezikut për degët dhe filialet e VIG, në secilin nga vendet, janë standard për të gjithë rregullatorët. Të dhënat e përfshira në këto formate vlerësimi, u diskutuan gjatë takimit, ku secili vend prezantoi, komentoi dhe analizoi kategoritë e veçanta të rreziqeve si ato makroekonomike, ligjore, rrezikun e investimeve, rrezikun e sigurimeve dhe atë të qeverisjes së shoqërive për secilën degë apo filial. Me këtë informacion Autoriteti Austriak, FMA, analizon rreziqet në nivel grupi.

Mbikëqyrësit nga secili rajon ju përgjigjën edhe pyetjeve drejtuar nga përfaqësuesja e EIOPA-s dhe përfaqësuesit e FMA-së lidhur me masat e marra për lehtësimin e rreziqeve dhe për përmirësimin e parametrave teknikë dhe financiarë në nivelet e lejuara rregullatore.

Drejtori Financiar i shoqërisë VIG prezantoi ecurinë, arritjet, strategjinë, si dhe rreziqet aktuale me të cilat përballlet Grupi VIG në vendet ku ata kanë shtrirë aktivitetin e tyre. Gjatë diskutimeve dhe pyetjeve, Drejtori Financiar i Shoqërisë VIG konfirmoi se nuk do të ketë ndryshim në strategjinë e ndjekur nga grupi VIG në Shqipëri.

Seminar për mbikëqyrjen me fokus rreziku për një treg sigurimi më të qëndrueshëm dhe transparent

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) zhvilluan në datat 7-9 tetor, në ambientet e Bankës Qendrore të Armenisë, seminarin rajonal për mbikëqyrjen me fokus rreziku për një treg sigurimi më të qëndrueshëm dhe transparent.

Disa nga çështjet kryesore që u trajtuan gjatë seminarit kishin të bënin me:

- » Mbikëqyrjen me fokus rrezikun - u shqyrtuan disa prej principeve bazë të sigurimeve dhe u vu në dukje roli i institucioneve financiare me ndikim global;
- » Vlerësimin sasior dhe cilësor të rrezikut, si dhe kalibrimi i kapitalit - u shqyrtuan identifikimi i rreziqeve, si dhe vlerësimi, matja e rrezikut duke përdorur një përjasje standarde;
- » Mbikëqyrjen dhe kërkesat e kapitalit për grupet e sigurimit;
- » Qeverisjen e korporatave;
- » Administrimin e rrezikut dhe kontrollet e brendshme;
- » Disiplinën e tregut dhe informimin e të siguruarve - u shqyrtuan asimetritë informative dhe nevoja për një paraqitje të qartë të informacionit nga siguruesit si për tregun, ashtu edhe për të siguruarit.

Temat e mësipërme u prezantuan nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare si IAIS, FSI, BIS (*Bank for International Settlements*), dhe nga autoritete rregullatore të vendeve të ndryshme.

Seminar për mbikëqyrjen e sigurimeve

Banka Qendrore e Holandës zhvilloi në datat 20-21 tetor në Amsterdam, Holandë, seminarin me temë “Për mbikëqyrjen e sigurimeve”. Në këtë seminar merrnin pjesë, përfaqësues nga bankat qendrore, ministritë e financave, autoritetet mbikëqyrëse dhe rregullatorë të tjerë të tregut financiar nga vende si Azerbajxhani, Çekia, Gjeorgjia, Indonezia, Lituania, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Rumania, Sllovakia, Turqia.

Ekspertë nga Banka Qendrore e Holandës prezantuan një organigramë të mbikëqyrjes së sigurimeve, që realizohet nga kjo bankë. Më pas prezantimi u përqendrua në metodologjinë e mbikëqyrjes të cilin e kishin titulluar “Fokus”. Sipas kësaj metodologjie bëhej një kategorizim i shoqërive të sigurimit duke marrë parasysh nëse përbënin shoqëri të vogla, të mesme, grupe kombëtare, ose ndërkombëtare. Më pas bëhej vlerësimi i rrezikut bazuar në kategorizimin e sipërpërmendur. Kjo metodologji e mbikëqyrjes ka për qëllim të jetë më e kujdesshme si dhe interaktive. Në vijim, ekspertët paraqitën praktikat e tyre lidhur me përzgjedhjen e drejtuesve të shoqërive në aspektet e integritetit, besueshmërisë dhe testimit të arsyeshmërisë dhe përshtatshmërisë.

Gjatë seminarit u diskutua gjithashtu mbi vlerësimin e aseteve dhe detyrimeve në regjimin e *Solvency II*. Me ngritjen e një metodologjie mbikëqyrje bazuar në identifikimin e vlerësimin e rreziqeve të siguruesve ka ndryshuar dhe regjimi i llogaritjes së kapitalit, i cili synon të përmirësojë sistemet e menaxhimit të rrezikut të siguruesve, lejon mbikëqyrësit të vlerësojnë më mirë profilet e rrezikut të tyre dhe përafrojnë metodologjinë mbikëqyrëse të vendeve të EU-së.

Lidhur me tregun e risigurimit u prezantuan karakteristikat e përgjithshme të tregut, rëndësia e tij, produktet e ndryshme të risigurimit, si dhe roli i rregullatorit e mbikëqyrësit në këtë treg. Gjithashtu, u diskutua dhe mbi risigurimin si një mekanizëm për transferimin e kapitalit, mbikëqyrjen, si dhe modelimin e katastrofave natyrore.

Në përfundim, në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve, u prezantuan praktikat e mbikëqyrjes së Bankës së Holandës. Me anë të përfshirjes së EIOPA-s dhe udhëzimeve të saj po punohet në drejtim të shkëmbimit të informacionit, vlerësimin të rrezikut të grupit, pjesëmarrjes në kolegjet mbikëqyrëse, ndërkohë që problematika qëndron ende në diversitetin e regjimeve rregullatore mes shteteve, si dhe balancën mes interesit të grupit dhe atij lokal.

Mbledhje e Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Group Austria

Autoriteti Austriak i Mbikëqyrjes (FMA) zhvilloi gjatë periudhës 21-23 tetor 2014, në Vjenë, Austri, mbledhjen e radhës së Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Group Austria, për rezultatet e këtij grupi gjatë vitit financiar 2013. AMF mori pjesë në këtë mbledhje si mbikëqyrës i dy filialeve të grupit UNIQA në Shqipëri.

Gjatë mbledhjes u diskutua drafti i marrëveshjes së koordinimit, i cili vazhdimisht përditësohet në përputhje me marrëveshjen përfundimtare të koordinimit të EIOPA-s dhe ndryshimet më të fundit që janë bërë në këtë marrëveshje. Versioni i përditësuar i këtij drafti pritet të firmoset nga vendet pjesëmarrëse të BE-së në fund të shkurtit 2015 e më pas dhe nga vendet e tjera.

Në mbledhje të Kolegjit të Mbikëqyrjes për shoqërinë UNIQA Group Austria, secili vend pjesëmarrës prezantoi dhe komentoi të dhënat e përfshira në formatin e vlerësimit të rrezikut për degët dhe filialet e UNIQA-s në vendin e tij, i cili ishte standard për të gjithë rregullatorët.

Secili vend pjesëmarrës analizoi kategoritë e veçanta të rreziqeve si: rreziqet makroekonomike, ligjore, të investimeve, të sigurimeve dhe atë të qeverisjes së shoqërive për secilën degë apo filial.

Përfaqësuesit e menaxhimit të lartë të shoqërisë UNIQA prezantuan arritjet, performancën, strategjinë, rreziqet aktuale me të cilat përballet Grupi UNIQA në vendet ku ata kanë shtrirë aktivitetin e tyre, si dhe përgatitjet e grupit për përshtatjen me *Solvency II*.

Seminar mbi kuadrin rregullator lidhur me shkeljet globale dhe ndërkufitare në fushën e letrave me vlerë

Organizata Ndërkombëtare e Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi në datat 21-24 tetor në Madrid, Spanjë seminarin mbi kuadrin rregullator lidhur me shkeljet globale dhe ndërkufitare në fushën e letrave me vlerë si dhe rolin e përdorimit të memorandumit multilateral të mirëkuptimit të IOSCO-s.

Temat e diskutuara gjatë ditëve të seminarit kishin të bënin me:

- » Zhvillimet e fundit dhe sfidat e reja në kuadrin rregullator, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit si një mënyrë për forcimin e tregjeve të kapitalit ndaj shkeljeve globale të letrave me vlerë;
- » Kryerjen efektive të inspektimeve të tregut kapital. Për vendet që kanë nënshkruar memorandumin multilateral të mirëkuptimit të IOSCO-s, pjesë e të cilit është edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, u diskutuan ndryshimet që do të bëhen në strukturat rregullatore;
- » Sfidat e reja teknologjike dhe skemat komplekse në kuadër të shkeljeve globale dhe ndërkufitare në fushën e letrave me vlerë, si dhe konkluzionet e arritura gjatë 15 viteve të fundit;
- » Përfshirjen më të zgjeruar të shteteve nënshkruese të memorandumit multilateral të mirëkuptimit të IOSCO-s;
- » Zbatueshmërinë e memorandumit multilateral të mirëkuptimit të IOSCO-s.

Qëllimi i këtij seminari ishte jo vetëm ofrimi i njohurive të reja në kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës në fushën e letrave me vlerë, por ai shërbeu edhe si një platformë për shkëmbimin e përvojës dhe informacionit midis rregullatorëve dhe grupeve të interesit lidhur me sfidat praktike me të cilat po përballen institucionet financiare.

LAJMET NGA RAJONI

GREQI

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve greke, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, shënoi vlerën e rreth 1.93 miliardë euro për primet e shkruara bruto, krahasuar me 1.97 miliardë euro një vit më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës përbëjnë 54.9% të totalit, me rreth 9% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i Jetës, arriti në vlerën e 870 milionë euro.

Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto u ulën me 0.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në sigurimin e Jo-Jetës, të gjitha klasat e rëndësishme raportuan rezultate negative: MTPL (-11.7%), sigurimi Kasko (-12.9%), dhe sigurimi i pronës (-8.3%).

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros (IAC), tregu i sigurimeve në Qipro, arriti në vlerën e 382 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2014. Kjo vlerë paraqet një rënie të primeve të shkruara bruto prej 2.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në sigurimin e Jetës, primet e shkruara bruto shënuan rënie me 7.2%, duke arritur në rreth 155 milionë euro, ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës, volumi i primeve të shkruara bruto arriti në rreth 227 milionë euro, me rritje 1.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Segmentet kryesore të sigurimit të Jo-Jetës, sigurimi nga aksidentet, shëndeti, zjarri dhe sigurimi motorik shënuan rritje.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2014, tregu i sigurimeve të Jetës në Qipro raportoi rezultat negativ.

RUMANI

www.xprimm.com

Tregu rumun i sigurimeve, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, shënoi ulje në rreth 6.8% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit kaluar.

Segmentet kryesore të sigurimit të Jo-Jetës u ulën me 6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit kaluar. Sipas raportit për tregun rumun, dy klasat e sigurimit të detyrueshëm, sigurimi TPL dhe sigurimi i detyrueshëm i pasurisë raportuan rritje të ndjeshme dhe mblodhën rreth 45% të primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Siguruesit sllovenë, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, njoftuan një vëllim të primeve të shkruara bruto në vlerën 1.05 miliardë euro, shifër kjo më e ulët në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i Jetës shënoi një rënie me 7.6% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në rreth 270.4 milionë euro.

Në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto kapën vlerën e rreth 785 milionë euro, ose 1.6% më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi motorik vazhdon të regjistrojë një trend negativ në volumin e primeve të shkruara bruto, megjithë përmirësimin e lehtë në tregun e shitjeve të makinave.

Raportohet se janë shitur 3% më shumë makina të reja të regjistruara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013. Trendi negativ që pësoi volumi i primeve të shkruara bruto MTPL ka ardhur kryesisht si rezultat i çmimeve konkurruese agresive midis kompanive të sigurimit, duke çuar në tarifa më të lira, si dhe ulje të mëdha.

Volumi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e pronës u rrit me rreth 2%, duke arritur në rreth 143 milionë euro. Nga ana tjetër, dëmet e paguara bruto në sigurimin e pronës shënuan një rritje me 5%, shkaktuar pjesërisht nga dukuritë natyrore, të cilat prekën tërë territorin e Sllovenisë në fillim të vitit 2014.